

09 Nëntor 2020

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI DHE MIRËKËPTIMI
MIDIS
DIASPORA PËR SHQIPËRINË E LIRË
DHE
QËNDRESA QYTETARE**

Diaspora për Shqipërinë e Lirë, organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, e bazuar në Zyrë, Zvicër, me fokus përfshirjen e mërgatës shqiptare në proceset politike dhe ato politikbërëse brenda Shqipërisë, më poshtë e referuar si “DPSHL” dhe Qëndresa Qytetare, qendër jofitimprurëse, bazuar në Tiranë, Shqipëri, me fokus fuqizimin e rolit të qytetarit në Shqipëri më poshtë e referuar si “QQ”, bashkë më poshtë të referuara si “Palët”, do të zhvillojnë format e bashkëpunimit në fushën e arsimit.

Palët bien dakort si më poshtë:

A. Qëllimi dhe fushëveprimi

- I. Memorandumi përcakton kushtet për bashkëpunimin dhe përgjegjësitë ndërmjet Palëve.
- II. Memorandumi synon të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin midis Palëve, në mënyrë jo-ekskluzive, në tematikat me interes të përbashkët në funksion të veprimtarisë në fushën e arsimit.

B. Përgjegjësitë e palëve

Palët bien dakord që:

- I. Të mbajnë dhe të ruajnë bashkëpunimin i cili respekton pavarësinë profesionale dhe transparencën e veprimtarisë;
- II. Të shkëmbejnë dokumente dhe informacione specifike në lidhje me aktivitetet dhe programet e punës që janë me interes për secilën nga Palët;
- III. Të zhvillojnë takime sipas nevojës për të diskutuar çështje me interes të përbashkët.

C. Fushat kryesore të angazhimit

Palët bien dakord të forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushat e mëposhtme:

- I. Cilësia e Arsimit të Lartë dhe adresimi serioz i problematikës së plagjiaturave.
- II. Studime kualitative të përgatitjes akademike të studentëve dhe pritshmërive të tregut të punës me grupet e interesit dhe hartimi i propozimeve/ raporteve alternative
- III. Transparenca e procesit të shpërndarjes së bursave të ekselencës.
- IV. Studime kualitative rreth fenomenit të largimit të studentëve jashtë vendit dhe mos kthimit të tyre pas eksperiencave arsimore jashtë vendit me qëllim nxitjen e rikthimit të trurit.
- V. Monitorimi i marrëdhënies student – pedagog dhe nxitja e llogaridhënies, transparencës dhe rritjes së nivelit shkencor tek stafi akademik.
- VI. Në realizimin e projekteve të përbashkëta si dhe promovimin e produkteve të tyre.



QËNDRESA
QYTETARE



DIASPORA
PËR SHQIPËRINË E LIRË

D. Trajtimi i informacioneve te shkëmbyera

- I. Palët zotohen të mos i kalojnë asnjë instance të tretë informacione të marra nga pala tjetër, pa aprovimin me shkrim të palës që ka dhenë informacionin.

E. Hyrja ne fuqi dhe afatzgjatja e Memorandumit

- I. Ky Memorandum hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Palët, ku data e firmës së fundit konsiderohet si data e hyrjes në fuqi.
- II. Mosmarrëveshjet, do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.
- III. Palët kanë të drejtë të ndryshojnë këtë memorandum pas konsultimeve dhe marrëveshjeve midis tyre.
- IV. Secila palë ka të drejtë të shkëpusë këtë marrëveshje, në çdo kohë, pas konsultimit paraprak të përbashkët dhe përmes një njoftimi zyrtar me shkrim.

Në emër të DPSHL

Firma

Florian Haxhaj

Emri nënshkruesit

Në emër të QQ

Firma

Rigels Xhoma

Emri nënshkruesit



Vendi dhe data: *Zürich, 10.11.2020*

Vendi dhe data: *Tinonë 09/11/2020*